LIGJ
Nr.7716, datë 2.6.1993

PËR NJË PËRJASHTIM NGA NENI 91 TË KODIT CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në përjashtim nga rregullat e parashikuara në nenin 91 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 1 janar 1990 deri 31 dhjetor 1992, personi që në bazë të një veprimi, i cili provohet me akt shkresor të thjeshtë, ka fituar (marrë) një shtëpi banimi pronë private në kushtet e kërkuara nga neni i sipërpërmendur, bëhet pronar i saj, në qoftës se e ka mbajtur atë në dorësi pa ndërprerje për një kohë më tepër se një vit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.573, datë 26.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.